



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKU

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Z. ILIR HALAJ

Miratur me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. , datë , 2022

Kryetar i Bashkisë

Z. TONIN MARINAJ

**DOKUMENTI I RISHIKIMIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA MALËSI E MADHE**

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. , datë , 2022

Drejtorja e Planifikimit Urban, Projekteve dhe Kadastrës: **ERMELINDA VOLAJ**

PËRMBAJTJA

KREU I	3
NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PLANIT	3
KREU II	12
NDRYSHIME NË TABELAT E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT TË NJËSIVE STRUKTURE	12
SHTOJCA I	22
HARTAT ILUSTRUESE E NJËSIVE STRUKTURE ME NDRYSHIME	22
SHTOJCA II	23
KOORDINATAT E NJËSIVE STRUKTURE QË PËSOJNË NDRYSHIME TË KUFIJVE	23
SHTOJCA III	24
PARAQITJA GRAFIKE E MBIVENDOSJES SË FASHAVE MBROJTËSE/TË REZERVIMIT TË RRUGËVE KOMBËTARE ME PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË MALËSI E MADHE DHE LISTA E NJËSIVE STRUKTURE PËRKATËSE	24

KREU I

NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PLANIT

Në “Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Malësi e Madhe”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në nenin 18 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7 dhe 8 me përmbajtje si më poshtë:

6. Për parcelat që shtrihen në dy apo më shumë përdorime të ndryshme, lejohet përfshirje e të gjithë sipërfaqes së parcelës në përlogaritjen e intensitet të ndërtimit në territorin me përdorimin e tokës me mundësi më të madhe zhvillimi vetëm nëse:

- a) Parcela ka mbi 50 % të sipërfaqes së saj, në njësinë me tregues zhvillimi më të lartë;
- b) Pronari, apo zhvilluesi e kërkon mundësinë e zhvillimit të gjithë parcelës me të drejta më të larta zhvillimi, me qëllim që të gjenerojë zgjerim të hapësirave me interes publik apo zhvillim në funksion të shtimit të shërbimeve të munguara në zonë.

7. Parcelat, të cilat shtrihen në më shumë se një njësi strukturore me mundësi të ndryshme zhvillimi, mund të përfshihen në njësinë strukturore me mundësi më të madhe zhvillimi, vetëm nëse plotësohen dy kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

- a) Një mundësi e tillë kërkohej nga pronari, apo zhvilluesi, dhe;
- b) Parcela/t ka/në mbi 50% të sipërfaqes së saj/tyre në atë njësi strukturore me tregues zhvillimi më të lartë .

8. Për të gjitha rastet e tjera, parcela do të parashikohet me mundësi të ndryshme zhvillimi, sipas kufirit të njërive strukturore, të cilat do të orientojnë zhvilluesit për riparcelizimet e nevojshme sipas mënyrave të zhvillimit të përcaktuara në këtë rregullore dhe planet e detajuara vendore.

2. Në nenin 29 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 1, shtohen pikat 1.1 deri në 1.6 si më poshtë:

1.1 “Vija blu”, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 686/2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” është vija kufizuese e zhvillimit me funksion mbrojtjen e të gjitha burimeve ujore.

1.2 “Brigjet”, sipas nenit 4, pika 8 të Ligjit Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve.

1.3 “Burimet ujore”, sipas nenit 4, pika 9 të Ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, janë të gjitha ujërat e brendshme detare, ujërat territoriale, vija bregdetare, zona ekonomike ekskluzive, shelfi kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse, reshjet atmosferike, nën juridiksionin dhe kontrollin e Republikës së Shqipërisë.

1.4 Veprimtaritë përbri brigjeve, sipas nenit 84 të Ligjit Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e

Interguar të burimeve ujore”, i ndryshuar, përcaktohen në planet dhe studimet e planifikimit dhe rregullimit të territorit.

1.5 Bazuar në këto dispozita “vija blu” në Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Malësi e Madhe përcaktohet nga kufiri i njësive strukturore pjesë e Sistemit Urban që përballen me burimin ujor, dhe në çdo rast “vija blu” duhet të respektojë brigjet ujore, duke mos i tejkaluar ato.

1.6 Në rastet kur vija blu e PPV-së tejkalon bregun e përcaktuar me vendime të posaçme të KKU-së, me VKM apo vendime të tjera (sipas legjislacionit sektorial në fuqi), prevalojnë kufizimet/kushtëzimet/rregullat për bregun sipas dispozitave përkatëse.

3. Pas nenit 33 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohet neni 33/1 me përmbajtjen si më poshtë:

NENI 33/1: Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm

- 1. Hartimi i Planit të Detajuar Vendor për njësitë strukturore të përcaktuara si subjekt hartimi i PDV-së, nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm në rastet e mëposhtme. Në këto raste, projektet mund të vijnë procedurat për pajisjen me leje zhvillimi/ ndërtimi, apo deklarata paraprake për kryerjen e punimeve, dhe të tjera të ngjashme, pa prituri hartimin dhe miratimin e PDV-së, por në përputhje me kuadrin ligjor të zhvillimit në fuqi.*
- 2. Gjatë hartimit të PDV-së, projektet e miratuara sipas përcaktimeve të këtij neni, duhet të integrohen në PDV.*
- 3. Rastet përjashtimore janë të aplikueshme vetëm në territore që nuk janë pjesë e Zonave të Rëndësishme Kombëtare, Brezit të Zhvillimit të Kontrolluar e Zonave me Përparësi Zhvillimin e Turizmit dhe përkufizohen si më poshtë:*
 - a. Për punime në infrastrukturë, të cilat nuk ndryshojnë treguesit e zhvillimit të njësive strukturore të PPV-së.*
 - b. Për punime që kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri, përveç rasteve të parashikuara në këtë nen.*
 - c. Për ndërtime të përkohshme.*
 - d. Për punime që realizojnë mirëmbajtje të jashtëzakonshme të objektit.*
 - e. Për punime si pasojë e emergjencave civile.*
 - f. Për punime që përmirësojnë aksesin e ndërtesave e strukturave për personat me aftësi të kufizuara.*
 - g. Kur kërkohet miratimi i projekteve për objekte dhe infrastrukturë publike, në respektim të parashikimeve të PPV-së. Treguesit e zhvillimit të dhëna për njësinë përkatëse do të jenë kufizuese për pronat subjekt i këtij rasti përjashtimor.*
 - h. Kur kërkohet të kryhen punime për ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ ndërtimi ose realizohen përmes deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.*

- i. Kur kërkohet rikonstrukcion, riparim dhe restaurim i një objekti ekzistues, për sa kohë këto punime nuk ndryshojnë treguesit e zhvillimit të njësisë.
- j. Kur kërkohet rindërimi i një banese të degraduar për ta kthyer atë në kushte të përshtatshme jetese, duke realizuar treguesit si KSHT, lartësia në kate dhe në metra (m), intensiteti i ndërtimit dhe distancat nga kufiri i pronës dhe objektet fqinjë, me vlera më të ulëta apo me të njëjtën vlerë si në gjendjen ekzistuese, ose sipas legjislacionit në fuqi (nëse ka parashikime të tilla).
- k. Kur kërkohet rikonstrukcioni i një banese ekzistuese me shtesë vëllimi, anësore apo në lartësi për qëllime që lidhen me banimin, për sa kohë objekti i rikonstruktuar nuk tejkalon treguesit e zhvillimit të njësisë. Në çdo rast, shtesa në lartësi nuk duhet të jetë më shumë se 1 kat dhe objekti të mos kalojë lartësinë 3 kat.
- l. Kur kërkohet zhvillimi i një banese një-familjare, e cila plotëson kushtet si më poshtë:
 - i. Është banesa e parë/ kryesore e banimit.
 - ii. Zhvillimi i tokës për banim me struktura një-familjare, është përdorim i lejuar nga PPV-ja në njësinë ku kërkohet zhvillimi.
 - iii. Lartësia maksimale e kërkesës për zhvillim është 2 ka/ 8m, ndërsa sipërfaqja totale e ndërtimit është jo më shumë se 250 m².
 - iv. Me përjashtim të kushteve të zhvillimit të përcaktuara në pikën “iii”, kërkesa për zhvillim duhet të respektojë treguesit e tjera të zhvillimit, sipas atyre të lejuara për njësinë strukturore të PPV-së.
 - v. Në rast se, treguesit e zhvillimit të njësisë për lartësinë e objektit, sipërfaqen totale të ndërtimit dhe parcelën minimale, janë më të vogla se ato të përcaktuara në gjendjen “iii”, më sipër, atëherë mbizotërojnë dhe zbatohen treguesit e zhvillimit të njësisë strukturore.”

4. Pas nenit 36 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohen nenet 36/1 dhe 36/2 me përmbajtje si më poshtë:

Neni 36/1: Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror

- 1. Në njësitë që i përkasin sistemit Urban, Bujqësor dhe Natyror lejohet zhvillimi i aktiviteteve agroturistike dhe ekoturistike, me kusht:
 - a. Respektimin e përcaktimeve ligjore në fuqi në fushën e bujqësisë, natyrës, mjedisit, pyjeve e kullotave, zonave të mbrojtura, etj, sipas territorit specifik;
 - b. Respektimin e përcaktimeve ligjore sektoriale në fushën e agroturizmit dhe ekoturizmit;
 - c. Bashkërendimin dhe marrjen e konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe zonave të rëndësisë kombëtare, sipas legjislacionit në fuqi;
 - d. Respektimin e kontekstit natyror/bujqësor dhe ruajtjen e peizazhit rural;
 - e. Sigurimin e pajisjes së strukturave të veprimtarisë agro/ekoturistike me infrastrukturën inxhinierike të nevojshme, sipas legjislacionit përkatës;

- f. *Moscënimi i infrastrukturës në funksion të tokës bujqësore (kanale kullues/vaditës, rrugë bujqësore, rezervuar, etj).*
2. *Nëse nuk përcaktohet ndryshe në pasaportën e njësisë strukturore përkatëse apo nga legjislacionit në fuqi, strukturat agroturistike nuk duket të kalojnë 2 kate me nënçati”.*
 3. *Riparimi, rinovimi, shtesat dhe përshtatja e strukturave ekzistuese të funksioneve të ndryshme të strukturave në funksion të agroturizmit dhe ekoturizmit është e lejuar me përmbushjen e përcaktimeve të këtij neni dhe në çdo rast, duke respektuar legjislacionin sektorial në fuqi. Strukturat ekzistuese mund të zgjerohen në respektim të pikës 2 të këtij neni.*
 4. *Pas miratimit të kërkesave për zhvillim/ndërtim agroturizmi/ekoturizmi në këto territore duhet të njoftohen zyrtarisht Ministria e Linjës për zhvillimet në fjalë.*
 5. *Nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të strukturave të agroturizmit dhe ekoturizmit në vijimësi.*

NENI 36/2: Kushte për objektet ekzistuese në sistemin Bujqësor dhe Natyror

1. *Strukturat e banimit (kategoria A-Banim, BA-Bujqësi-Banim), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe rindërtimit, me të drejtë shtesë mbi sipërfaqen e përgjithshme të tyre, vetëm një herë.*
2. *Strukturat e banimit mund të rikonstruktohen si dhe rindërtohen duke shtuar mbi parametrat e gjendjes ekzistuese 1 kat ose 30% të sipërfaqes totale pa kaluar lartësinë maksimale 3 kat. Në rast shtese të vëllimit anësor, shtesa duhet të lejohet vetëm nëse plotësohet kushti që toka të mos ketë bonitet të kategorisë I-IV. Në këto raste (shtesa të vëllimit anësor) koeficienti total i shfrytëzimit të parcelës për ndërtim nuk duhet të kalojë 50%.*
3. *Strukturat ekzistuese të funksionit banim të përfshira në brezat buferik/brezat e rezervimit të burimeve ujore, varrezave, infrastrukturave rrugore, monumenteve të natyrës, monumenteve të kulturës, etj, mund t'i nënshtrohen punimeve të rikonstruksionit sipas përcaktimeve të legjislacionit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në fuqi, pa shtesa volumore anësore apo në lartësi.*
4. *Strukturat ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së dhe të paregjistruara, i nënshtrohen procedurave në fuqi për legalizimin dhe regjistrimin në Kadastër, edhe në rastet kur përcaktimet e Planit për përdorimin e tokës dhe treguesit e zhvillimit nuk lejojnë zhvillimin, rrizhvillimin, ristrukturimin, apo forma të tjera ndërhyrje në territorin ku ato ndodhen.*
5. *Rekomandohet transformimi i strukturave ekzistuese: ish reparte ushtarake jashtë funksionit, banesa, struktura apo objekte sot pa funksion në struktura të Shërbimeve – nënkategoria S1-Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi dhe/ose EB3-Agroturizëm. Këto struktura mund të pasurohen me struktura ekologjike Ekoturizmi NAR4 si dhe hapësira për kampingje me çadra.*
6. *Strukturat e shërbimit (S-Shërbime), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe/ose rindërtimit, me të drejtë shtese mbi gjurmën ekzistuese, vetëm në lartësi, vetëm një herë dhe pa kaluar lartësinë maksimale 3K.*

7. *Strukturat industriale-ekonomike (IE-Industri dhe Ekonomi), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes (në kushtet e emergjencës) pa të drejtë shtese vëllimore. Në vazhdimësi, në bashkëpunim me subjektet private-pronare, bashkia duhet të marrë masat për rivendosjen/ zhvendosjen e tyre në territoret e përcaktuara për përdorim të kategorisë IE_Industri dhe Ekonomi.*
5. Në nenin 41 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:
- Në kreun “A. Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet për zhvillim”, pika “7- Kushte për PDV”, shtohet fraza “Përfshirje në njësi KA_05-A13-04/1, për të cilën nuk ka nevojë të hartohet PDV”.
 - Në kreun “B. Rregullat e vullmit”, pika “5-Lartësia maksimale e lejuar”, shtohet fraza “Përfshirje në njësi KA_05-A13-04/1, për të cilën lartësia është 5K”.
6. Në nenin 42 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:
- Në kreun “A. Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet për zhvillim”, pika “7-Kushte për PDV”, shtohet fraza “Përfshirje në njësi KO_03-A14-09, KO_03-A14-10 dhe njësi KO_03-A14-05/1, për të cilat nuk ka nevojë të hartohet PDV”.
 - Në kreun “B. Rregullat e vullmit”, pika “5-Lartësia maksimale e lejuar”, shtohet fraza “Përfshirje në njësi KO_03-A14-05/1, për të cilën lartësia është 3K”
7. Në nenin 46 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:
- Në kreun “B. Rregullat e vullmit”:
 - pika “2- Koeficienti maksimal i shfrytëzimit”, shtohet fraza “Përfshirje në njësi QE_02-A23-02, për të cilën KSHT është 30%”;
 - pika “4- Koeficienti minimal për hapësira publike të hapura”, shtohet fraza “Përfshirje në njësi QE_02-A23-02, për të cilën KSHP është 50%”;
8. Në nenin 48 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:
- Në kreun “B. Rregullat e vullmit”:
 - Pika “1-Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për zonën”, shtohet fraza “Përfshirje në njësi KE_05-A31-05, për të cilën intensiteti është 1.2”;
 - pika “2-Koeficienti maksimal i shfrytëzimit”, shtohet fraza “Përfshirje në njësi KE_05-A31-05 dhe KE_05-A31-06, për të cilat KSHT është 35%”;
 - pika “5-Lartësia maksimale e lejuar”, shtohet fraza “Përfshirje në njësi KE_05-A31-05, për të cilën lartësia është 3K dhe njësi KE_05-A31-06, për të cilën lartësia është 4K.
9. Në nenin 49 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:

i. Në kreun “B. Rregullat e volumnit”:

- a. pika “1-Intensiteti maksimal i lejuar i ndërimit për zonën”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE_01-A32-02/1, për të cilën intensiteti është 0.5”;
- b. pika “2-Koeficienti maksimal i shfrytëzimit”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE_01-A32-07, KE_01-A32-02/1, për të cilën KSHT është 35%”;
- c. pika “5-Lartësia maksimale e lejuar” shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE_01-A32-07 dhe KE_01-A32-02/1, për të cilën lartësia është 3K.”.

10. Në nenin 50 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:

i. Në kreun “B. Rregullat e volumnit”:

- a. pika “1-Intensiteti maksimal i lejuar i ndërimit për zonën”, nga “0.2 e parcelës individuale” shtohet fraza “Përjashtim bën njësia SH_08-A33-05, për të cilën intensiteti është 1”;
- b. pika “2-Koeficienti maksimal i shfrytëzimit”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia SH_08-A33-05, për të cilën është koeficienti maksimal i shfrytëzimit është 30%”;
- c. pika “5-Lartësia maksimale e lejuar”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia SH_08-A33-05, për të cilën lartësia maksimale e lejuar është 3K/ 11metra”.

11. Në nenin 51 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:

i. Në kreun “A. Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet për zhvillim”, pika “7-Kushte për PDV”,

- a. Pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi i tretë, me përmbajtje: “Përjashtim bëjnë njësitë KE_02-A34-01, KE_02-A34-01/1 dhe KE_02-A34-01/2, për të cilat nuk ka nevojë të hartohet PDV”
- b. fraza “Njësia KE_02-A34-01 do të trajtohet me PDZRK së bashku me njësitë KE_02-S-01 dhe KE_02-S-02” ndryshon në “Njësitë KE_02-S-01 dhe KE_02-S-02 do të trajtohen me PDZRK”;

ii. Në kreun “B. Rregullat e volumnit”:

- a. pika “5-Lartësia maksimale e lejuar”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE_02-A34-01, për të cilën lartësia është 4K”.

12. Në nenin 54 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:

ii. Në kreun “A. Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet për zhvillim”, pika “7-Kushte për PDV”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KA_04-IE2-01, për të cilën nuk ka nevojë të hartohet PDV”.

iii. Në kreun “B. Rregullat e volumnit”:

- d. pika “3-Koeficienti minimal për rrugë”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KA_04-IE2-01, për të cilën KSHR është 20%”;

- e. pika “4-Koeficienti minimal për hapësira publike të hapura”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KA_04-IE2-01, për të cilën KSHP është 20%”;

13. Në nenin 55 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:

- i. Në kreun “A. Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet për zhvillim”:
- a. pika “7-Kushte për PDV”, fraza “Njësitë KE_02-S-01 dhe KE_02-S-02 që do të trajtohen me PDZRK së bashku me njësinë KE_02-A34-01.” ndryshon në “Njësitë KE_02-S-01 dhe KE_02-S-02 që do të trajtohen me PDZRK”.
- b. pika “7-Kushte për PDV”, shtohet fraza “Njësia KO_01-S-01 do të trajtohet me PDV”.
- ii. Në kreun “B. Rregullat e volumit”:
- a. pika “2-Koeficienti maksimal i shfrytëzimit”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE_05-S-01, për të cilën KSHT është 50%”.

14. Në nenin 65 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pika 3 ndryshon si më poshtë:

- “3. Parametrat e zhvillimit dhe funksionet sipas kategorisë AR3 do të përcaktohen në lejet e zhvillimit, në përputhje me nevojat e vendbanimit si dhe duke respektuar intensitetin maksimal 2”.

15. Në nenin 68 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pika 3 riformulohet si më poshtë:

3. Varrezat duhet të jenë të izoluara nga zonat e banimit nëpërmjet brezit të rezervuar. Ndalohej ndërtim të reja apo të zgjerohen ato ekzistuese brenda brezit të rezervuar.
- Në qendrat e banuara me popullsi mbi 10.000 banorë, gjerësia e zonës së rezervuar duhet të jetë më e madhe se 100 metra nga vija kufizuese e qendrës së banuar dhe për ato me popullsi më të vogël se 10.000 banorë, duhet të jetë më e madhe se 50 metra.
- Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe, ka të drejtë të zvogëlojë gjerësinë e brezit të rezervuar, vetëm me vendim të motivuar të tij dhe duke marrë mendimin e Inspektoriatit Sanitar.
- Varreza private mund të ngrihen nga subjekte private mbi troje në pronësi të tyre. Ngritja e varrezave private do të bëhet me miratim të Këshillit të Bashkisë. Kriteret dhe procedurat për ngritjen e varrezave private përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

16. Në nenin 77 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 3, shtohen pikat 4 deri në 7 si më poshtë:

4. Njësitë të cilat preken nga kalimi i linjave ose kanë si pjesë përbërëse/kufizohen nga Hekurudha duhet të zbatojnë kuadrin ligjor të Ligjit Nr. 142/2016, datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.
5. Përkufizime:
- a. “Brez i vijës hekurudhore” është toka në të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi

minimale 5 metra, duke u nisur nga fundi i skarpatës së trasesë, kur nuk ka kanale, dhe nga fundi i kanaleve mbrojtëse dhe kulluese.

- b. “Brez mbrojtës i vijës hekurudhore” është brezi i tokës nga të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi 100 metra, nisur nga ekstremi i jashtëm i brezit të vijës hekurudhore.
- c. “Hapësirë ajrore hekurudhore” është hapësira mbi linjën hekurudhore, në lartësi 12 metra nga niveli i kokës së shinës, në të gjithë gjerësinë e brezit të vijës hekurudhore, ndërsa në kryqëzimet me linjat elektrike mbi 220 kilovolt hapësira është 14 m.

6. Në funksion të mbrojtjes së vijës hekurudhore, si dhe për të siguruar mbrojtjen e vijave hekurudhore ndalohet:

- a. hapja më afër se 100 metra nga brezi i vijës hekurudhore i gurorëve, zhavorrishteve e ranishtave, gërmimi masiv i dheut dhe hapja e kanaleve. Për ndërtimin e këtyre objekteve, në distancë 100-200 metra nga brezi i vijës hekurudhore, merret leje nga administruesi i infrastrukturës hekurudhore;
- b. Çdo lloj ndërtimi, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë vijës hekurudhore, më pranë se 25 metra nga brezi i kësaj vije, për territoret jashtë zonave urbane. Por, në këto zona lejohet ndërtimi i ndërtesave të banimit dhe i ndërtesave të tjera, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë brezit të vijës hekurudhore, në distancë 25-100 metra nga ky brez.

7. Për ndërtimin e çdo lloj objekti, që ndodhet në zonat urbane, jashtë brezit të vijës hekurudhore dhe në distancë deri në 25 metra nga ky brez, kërkohet leje nga administruesi i infrastrukturës hekurudhore.

17. Pas nenit 80 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohet neni 80/1 me përmbajtjen si më poshtë:

NENI 80/1: Kanalet vaditëse/Emisaret

- 1. Njësitë që preken/kanë si pjesë përbërëse, ose kufizuese kanalet vaditëse/emisaret, duhet të zbatojnë kuadrin ligjor të Ligjit Nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”.
- 2. Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si të tilla:
 - a. ndërtimi, rehabilitimi ose modifikimi i një sistemi ujitjeje apo kullimi pa lejen përkatëse;
 - b. dëmtimi i sistemit të ujitjes, i sistemit të kullimit ose i veprave të mbrojtjes nga përmytja;
 - c. ndërtimi i paautorizuar mbi sistemet e ujitjes, sistemet e kullimit ose veprat e mbrojtjes nga përmytja;
 - d. ndërtimi i paautorizuar mbi sistemet e ujitjes, sistemet e kullimit ose veprat e mbrojtjes nga përmytja;
 - e. ndërtimi ose ngritja e çdo ndërtese apo strukture, mbjellja e pemëve më afër se **8 metra**

nga bordura e kanalit kryesor (vija e takimit të sipërfaqes së tokës me skarpatën e kanalit kullues ose vija e takimit të skarpatës së jashtme të bankinës së kanalit ujitës me sipërfaqen e tokës), ose e një sistemi kryesor kullimi, apo më afër se **4 metra** nga bordura e çfarëdo kanali ujitjeje ose kullimi.

18. Në nenin 88 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:

- i. Në kreun “B. Rregullat e volumit”:
 - a. pika “1-Intensiteti maksimal i lejuar i ndërimit për zonën”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KA_01-B2-08, për të cilën intensiteti është 0.5”;
 - b. pika “2-Koeficienti maksimal i shfrytëzimit”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KA_01-B2-08, për të cilën KSHT është 35%”;

19. Në nenin 89 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:

- i. Në kreun “Rregullat e zhvillimit per parcela individuale”:
 - a. pika “1-Intensiteti maksimal i lejuar për zonën”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE_07-B3-08, për të cilën intensiteti është 0.5”.
 - b. pika “2- Koeficienti maksimal i shfrytëzimit”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE_07-B3-08 dhe njësia SH_10-B3-01, për të cilat KSHT është 15%;
 - c. pika “5- Lartësia maksimale e lejuar”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE_07-B3-08, për të cilën lartësia është 2K+nënçati e shfrytëzueshme 50%”.

20. Në nenin 100 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 6, shtohen pikat 7 deri në 9 si më poshtë:

7. Kushdo ka të drejtë të përdorë lirisht burimet ujore sipërfaqësore për të pirë dhe për nevoja të tjera shtëpiake e të blegtorisë, pa tejkalluar nevojat, sasitë e nevojshme për plotësimin e nevojave individuale dhe familjare të përdoruesit dhe në përputhje me ligjet dhe planet përkatëse të këshillave të baseneve.
8. Ndërtimi i puseve, qoftë për përdorim bujqësor dhe industrial, është i pranueshëm vetëm nëse është në përputhje me nenin 57 të Ligjit Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar.
9. Kushdo ka të drejtë të përdorë ujin e shiut që bie në tokë private, me kusht që ky ujë të mos jetë mbledhur në instalime artificiale.

KREU II

NDRYSHIME NË TABELAT E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT TË NJËSIVE STRUKTUREORE

Në “Tabelat e Treguesve të Zhvillimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Malësi e Madhe”, në Rregulloren e Planit, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon. Paraqitja grafike e ndryshimeve do të bëhet sipas koordinatave në Shtojcën II të këtij dokumenti.

1. Në pasaportat e njësive strukturore sipas Shtojcës III, pika a) dhe b) të këtij dokumenti, të prekura nga zonat e rezervimit të akseve rrugore:
 - a) “Koplik-Qafë Thore”, kategoria C, (min. 10m nga trupi i rrugës);
 - b) “Hani i Hotit-Tamarë-Vermosh”, kategoria C (min. 10m nga trupi i rrugës) sipas PPV;shtohet kutiza “Kushtëzime ligjore” me përmbajtje si më poshtë: “VKM Nr.153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE_01-A32-01:
 - a) Lartësia, nga “2 kate” ndryshon në “2 kate+nënçati e shfrytëzueshme 50%;
 - b) KSHR, nga “20%” ndryshon në “15%”.
3. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE_01-A32-07:
 - a) Lartësia, nga “2 kate” ndryshon në “3 kate;
 - b) KSHT, nga “25%” ndryshon në “35%”.
4. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE_01-A32-02:
 - a) Sipërfaqe (ha), nga “26.14” ndryshon në “25.26”.
5. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” shtohet njësia strukturore KE_01-A32-02/1:
 - a) Njësia administrative, “Kelmend”;
 - b) Zonimi në territor, “KE_01”;
 - c) Sistemi, “UB-Urban”;
 - d) Kategoria, “A3-Zona Rurale Fushore”;
 - e) Përdorimi, “A32 – Zona Densifikimi”;
 - f) Njësia, “KE_01-A32-02/1”;
 - g) Zona e mbrojtur, “N/A”;
 - h) KSHT, “35%”.
 - i) KSHR, “20%”;
 - j) KSHP, “20%”;
 - k) Intesiteti, “0.5”;
 - l) Intesiteti me kusht, “N/A”

- m) Dendësia/Banorë, “20 banorë/ha”;
- n) Lartësia, “3 kate”;
- o) Lloji i ndërhyrjes, “Krijim, Rinovim, Plotësim”;
- p) Shërbime, “Neni 45, pika A5”;
- q) PDV, “N/A”;
- r) Prioriteti, “-”;
- s) Kategoritë e kushtëzuara dhe ndaluara, “Neni 7”;
- t) Funksionet aktuale, “Neni 6”;
- u) Sipërfaqe, “0.87ha”.

6. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” shtohet njësia strukturore **KE_02-N21-11/1:**

- a) Treguesit e njësisë janë të njëjtë me ata të njësisë strukturore KE_02-N21-11 përveç:
 - i. Njësia, “KE_02-N21-11/1”;
 - ii. Kushtëzime ligjore, “Në këtë njësi nuk lejohet aplikimi i Vendimit të KKT Nr. 12, datë 27.02.2019 “Për miratimin e Lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në Njësitë që i përkasin sistemit Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N)” për arsye të ruajtjes së zonës ku zhvillohet historikisht eventit artistik “Logu i Bjeshkëve””;
- b) Sipërfaqja e njësisë (ha) “_____”;
- c) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.



Commented faf11:

7. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore **KE_02-N21-11:**

- a) Sipërfaqja e njësisë (ha) nga “5.66” ndryshon në “_____”;
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

8. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore **KE_02-A34-01:**


- c) PDV, nga “PDZRK” ndryshon në “N/A”;
- d) Lartësia, nga “2 kate” ndryshon në “4 kat”;
- e) Sipërfaqja e njësisë (ha) nga “_____” ndryshon në “_____”;
- f) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.



Commented faf21:

9. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” shtohet njësia strukturore **KE_02-A34-01/1:**


- a) Treguesit e njësisë janë të njëjtë me ata të njësisë strukturore KE_02-A34-01 përveç:
 - i. Njësia, “KE_02-A34-01/1”
 - ii. Lartësia 2K+nënçati të shfrytëzueshme 50%;
- b) Sipërfaqja e njësisë (ha) “_____”;
- c) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.



Commented faf31:

10. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” shtohet njësia strukturore **KE_02-A34-01/2:**

- a) Treguesit e njësisë janë të njëjtë me ata të njësisë strukturore KE_02-A34-01 përveç:
 - i. Njësia, “KE_02-A34-01/2”
 - ii. Lartësia 2K+nënçati të shfrytëzueshme 50%;
- b) Sipërfaqja e njësisë (ha) “_____”;



Commented faf41:

c) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

11. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE_05-AS-02:

- a) *Njësia*, nga “KE_05-AS-02” ndryshon në “KE_05-SH-02”;
- b) *Kategoria*, nga “AS-Arsim” ndryshon në “SH-Shëndetësi”;
- c) *Përdorimi*, nga “AS-Zonë Objektsh Shkollore” ndryshon në “SH-Shërbim shëndetësor”;

12. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE_05-S-02:

- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “0.19” ndryshon në “0.3”.
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

13. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE_05-A31-06:

- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “2.0” ndryshon në “2.03”;
- b) *Lartësia*, nga “2 kate” ndryshon në “4 kate”;
- c) *KSHT*, nga “20%” ndryshon në “35%”;
- d) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

14. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE_05-SH-01:

Hiqet nga Tabela e Treguesve të Zhvillimit të njësive strukturore dhe hartat ilustruese të Planit.

15. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE_05-A31-05:

- a) *Sipërfaqe*, nga “0.37” ndryshon në “0.44”;
- b) *Lartësia*, nga “2 kate” ndryshon në “3 kate”;
- c) *Intensiteti*, nga “0.2” ndryshon në “1.2”;
- d) *KSHT*, nga “20%” ndryshon në “35%”;
- e) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

16. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE_05-N11-01:

- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “757.49” ndryshon në “_____”;
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

17. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE_05-S-01:

- a) *KSHT*, nga “40%” ndryshon në “50%”;

18. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE_07-B3-08:

- a) *Lartësia*, nga “2 kate” ndryshon në “2 kat + nënçati e shfrytëzueshme 50%”;
- b) *Intensiteti*, nga “0.2” ndryshon në “0.5”;
- c) *KSHT*, nga “10%” ndryshon në “15%”.

19. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KA_05-A13-04:

- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “4.04” ndryshon në “3.33”;
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

20. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” shtohet njësia strukturore KA_05-A13-04/1:

- a) Treguesit e njësise janë të njëjtë me ata të njësise strukturore KA_05-A13-04 përveç:
 - i. Njësia, “KA_05-A13-04/1”;
 - ii. Lartësia (kate) 5K;
 - iii. PDV, N/A;
- b) Sipërfaqja e njësise (ha) “0.71”;
- c) Koordinatat e njësise jepen në Shtojcën II.

21. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” shtohet njësia strukturore KA_04-IE2-01:

- a) Treguesit e njësise janë të njëjtë me ata të njësise strukturore KO_04-IE2-02 përveç:
 - i. Njësia administrative, “Kastrat”;
 - ii. Zonimi në territor, “KA_04”;
 - iii. Njësia, “KA_04-IE2-01”;
 - iv. PDV, N/A;
 - v. KSHR, 20%;
 - vi. KSHP, 20%;
- b) Sipërfaqja e njësise (ha) “4.32”;
- c) Koordinatat e njësise jepen në Shtojcën II.

22. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KO_04-IE2-02:

- a) Sipërfaqe, nga “22.86” ndryshon në “18.55”.

23. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore QE_02-IE2-03:

- a) Njësia administrative, nga “Qendër” ndryshon në “Kastrat”;
- b) Zonimi në territor, nga “QE_02” ndryshon në “KA_02”;
- c) Njësia, nga “QE_02-IE2-03” ndryshon në “KA_02-IE2-03”.

24. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” shtohet njësia strukturore KA_01-B2-08:

- a) Treguesit e njësise janë të njëjtë me ata të njësise strukturore KA_01-B12-01 përveç:
 - i. Njësia, “KA_01-B2-08”;
 - ii. Kategoria, “B2-Aktivite ekonomike bujqësore”;
 - iii. Përdorimi, “B2- Prodhimtari, Përpunim, Tregtim”
 - iv. Lartësia, “1kat”;
 - v. Intensiteti, “0.5”;
 - vi. KSHT, “35%”;
- b) Sipërfaqja e njësise (ha) “0.23”;
- c) Koordinatat e njësise jepen në Shtojcën II.

25. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KA_01-B12-01:

- a) Sipërfaqe (ha), nga “18.60” ndryshon në “18.37”.
- b) Koordinatat e njësise jepen në Shtojcën II.



26. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore SH_08-N22-06:

- a) *Njësia*, nga "SH_08-N22-06" ndryshon në "SH_08-N11-08";
- b) *Kategoria*, nga "N2-Kullota" ndryshon në "N1-Pyje";
- c) *Përdorimi*, nga "N22-Kullota natyrore, stane" ndryshon në "N11-Pyje natyrore".

27. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore SH_10-B3-01:

- a) *KSHT*, nga "10%" ndryshon në "15%";

28. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore KO_03-A14-09:

- a) *PDV*, nga "PDV" ndryshon në "N/A".
- b) *Sipërfaqe (ha)*, nga "0.71" ndryshon në "0.85".
- c) *Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.*

29. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore KO_03-A11-23

- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga "2.11" ndryshon në "1.96".
- b) *Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.*

30. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore KO_03-A14-10:

- a) *PDV*, nga "PDV" ndryshon në "N/A".

31. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore KO_03-A12-14:

- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga "5.88" ndryshon në "5.8".
- b) *Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.*

32. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" shtohet njësia strukturore KO_03-A14-12:

- a) *Njësia administrative*, "Koplik";
- b) *Zonimi në territor*, "KO_03";
- c) *Sistemi*, "UB-Urban";
- d) *Kategoria*, "A-Banim";
- e) *Përdorimi*, "A14-Zona të reja Dendësi e mesme";
- f) *Njësia*, "KO_03-A14-12";
- g) *Zona e mbrojtur*, "JO";
- h) *KSHT*, "LZH/ Sipas projektit".
- i) *KSHR*, "LZH/ Sipas projektit";
- j) *KSHP*, "LZH/ Sipas projektit";
- k) *Intesiteti*, "LZH/ Sipas projektit";
- l) *Intesiteti me kusht*, "N/A"
- m) *Dendësia/Banorë*, "100 përdorues/ha";
- n) *Lartësia*, "LZH/Sipas projektit";
- o) *Lloji i ndërhyrjes*, "Rigjenerim dhe Krijim";
- p) *Shërbime*, "-";

- q) *PDV*, “N/A”;
- r) *Prioriteti*, “-”;
- s) *Kategoritë e kushtëzuara dhe ndaluara*, “Neni 7”;
- t) *Funksionet aktuale*, “Neni 6”;
- u) *Sipërfaqe*, “0.861ha”.
- v) *Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II*.

33. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore **KO_03-A14-05:**

- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “3.24” ndryshon në “2.6”.
- b) *Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II*.

34. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” shtohet njësia strukturore **KO_03-A14-05/1:**

- a) *Treguesit e njësisë janë të njëjtë me ata të njësisë strukturore KO_03-A14-05 përveç:*
 - i. *Njësia*, “KO_03-A14-05/1”;
 - ii. *Lartësia (kate)*, “3 kate”;
 - iii. *PDV*, “N/A”;
- b) *Sipërfaqja e njësisë (ha)* “0.63”;
- c) *Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II*.

35. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore **SH_08-A33-05:**

- a) *KSHT*, nga “20%” ndryshon në “30%”.
- b) *Intesiteti*, nga “0.2” ndryshon në “1”;
- c) *Lartësia*, nga “2 kate” ndryshon në “3 kate”;

36. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore **KO_03-IE2-02:**

- a) *Njësia*, nga “KO_03-IE2-02” ndryshon në “KO_03-A12-15”
- b) *Kategoria*, nga “IE-Zona Industriale dhe Ekonomike” ndryshon në “A1-Zona banimi urbane”.
- c) *Përdorimi*, nga “IE2-Zona Aktivitete Ekonomike” ndryshon në “A12-Zona në Zhvillim”.

37. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore **KO_01-S-01:**

- a) *PDV*, nga “PDZRK” ndryshon në “PDV”;

38. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore **QE_02-AR3-01:**

- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “20.85” ndryshon në “27.40”.
- b) *Njësia administrative*, nga “Qendër” ndryshon në “Koplik”;
- c) *Zonimi në territor*, nga “QE_02” ndryshon në “KO_02”;
- d) *Njësia*, nga “QE_02-AR3-01” ndryshon në “KO_02-AR3-01”;
- e) *KSHT*, nga “Neni 65, Pika 3” ndryshon në “LZH/Sipas projektit”;
- f) *KSHR*, nga “Neni 65, Pika 3” ndryshon në “LZH/Sipas projektit”;
- g) *KSHP*, nga “Neni 65, Pika 3” ndryshon në “LZH/Sipas projektit”;
- h) *Intesiteti*, nga “Neni 65, Pika 3” ndryshon në “LZH/Sipas projektit”;
- i) *Lartësia*, nga “Neni 65, Pika 3” ndryshon në “LZH/Sipas projektit”;

- j) Shërbime, nga “Neni 65, Pika 3” ndryshon në “LZH/Sipas projektit;
- k) PDV, nga “PDV” ndryshon në “LZH/Sipas projektit;
- l) Koordinatat e njësive jepen në Shtojcën II.

39. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore QE_02-IE2-02:

- a) Sipërfaqe (ha), nga “3.09” ndryshon në “1.76”.
- b) Koordinatat e njësive jepen në Shtojcën II.

40. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore QE_02-IE1-05:

- a) Sipërfaqe (ha), nga “10.94” ndryshon në “5.72”.
- b) Koordinatat e njësive jepen në Shtojcën II.

41. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” shtohet njësia strukturore QE_02-A23-02:

- a) Njësia administrative, “Qendër”;
- b) Zonimi në territor, “QE_02”;
- c) Sistemi, “UB-Urban”;
- d) Kategoria, “A2-Zonë rurale fushore”;
- e) Përdorimi, “A23-Qendra vendbanimi/zona mikse”;
- f) Njësia, “QE_02-A23-02”;
- g) Zona e mbrojtur, “Jo”;
- h) KSHT, “30%”;
- i) KSHR, “20%”;
- j) KSHP, “50%”;
- k) Intesiteti, “0.5”;
- l) Intesiteti me kusht, “N/A”
- m) Dendësia/Banorë, “50 banorë/ha”;
- n) Lartësia, “2 kate+nënçati e shfrytëzuar”;
- o) Lloji i ndërhyrjes, “Sistemim. Rigjenerim”;
- p) Shërbime, “10%”;
- q) PDV, “N/A”;
- r) Prioriteti, “-”;
- s) Kategoritë e kushtëzuara dhe ndaluara, “Neni 7”;
- t) Funksionet aktuale, “Neni 6”;
- u) Sipërfaqe, “3.02ha”;
- v) Koordinatat e njësive jepen në Shtojcën II.

42. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore QE_02-B12-03:

- a) Sipërfaqe (ha), nga “5.55” ndryshon në “2.53”.
- b) Koordinatat e njësive jepen në Shtojcën II.

43. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore GR_02-B11-22:

Hiqet nga Tabela e Treguesve të Zhvillimit të njësive strukturore dhe hartat ilustruese të Planit.



44. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" shtohet njësia strukturore GR_02-B12-01:

- a) *Njësia administrative, "Gruemirë";*
- b) *Zonimi në territor, "GR_02";*
- c) *Sistemi, "B-Bujqësor";*
- d) *Kategoria, "B1-Zona bujqësore";*
- e) *Përdorimi, "B12-Toka Bahçe";*
- f) *Njësia, "GR_02-B12-01";*
- g) *Zona e mbrojtur, "JO";*
- h) *KSHT, "10%";*
- i) *KSHR, "N/A";*
- j) *KSHP, "N/A";*
- k) *Intesiteti, "0.1";*
- l) *Intesiteti me kusht, "N/A";*
- m) *Dendësia/Banorë, "10 banorë/ha";*
- n) *Lartësia, "2 kate";*
- o) *Lloji i ndërhyrjes, "Mbrojtje";*
- p) *Shërbime, "0";*
- q) *PDV, "N/A";*
- r) *Prioriteti, "-";*
- s) *Kategoritë e kushtëzuara dhe ndaluara, "Neni 7";*
- t) *Funksionet aktuale, "Neni 6";*
- u) *Sipërfaqe, "0.63ha";*

45. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore GR_01-IN7-01:

- c) *Sipërfaqe (ha), nga "21.8" ndryshon në "21.67";*
- d) *Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.*

46. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore GR_01-N11-03:

- a) *Sipërfaqe (ha), nga "24.7" ndryshon në "24.66";*
- b) *Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.*

47. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore GR_05-IN7-0:

- a) *Sipërfaqe (ha), nga "13.80" ndryshon në "13.81";*
- b) *Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.*

48. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore GR_05-N12-01:

- a) *Sipërfaqe (ha), nga "8.8" ndryshon në "8.14";*
- b) *Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.*

49. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore GR_05-U23-01:


- a) *Sipërfaqe (ha), nga "6.9" ndryshon në "6.84";*
- b) *Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.*

50. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore GR 07-A21-03:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “5.5” ndryshon në “5.58”.
 - b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
51. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore GR 07-B11-02:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “57.4” ndryshon në “57.02”.
 - b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
52. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore GR 07-B12-01:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “5.8” ndryshon në “7.03”.
 - b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
53. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore GR 07-N11-01:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “1,233.3” ndryshon në “939.57”.
 - b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
54. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore GR 10-N11-01:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “2,874.3” ndryshon në “2,695.34”.
 - b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
55. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE 02-N11-02:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “1,587.0” ndryshon në “1,501.23”.
 - b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
56. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE 04-N11-02:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “599.4” ndryshon në “497.24”.
 - b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
57. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE 04-N11-04:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “2,788.6” ndryshon në “1,592.56”.
 - b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
58. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE 04-N11-10:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “1,815.8” ndryshon në “1,431.22”.
 - b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
59. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore KE 04-N11-21:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “561.9” ndryshon në “553.61”.
 - b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
60. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore N11-01:

- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “658.0” ndryshon në “657.83”.
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
61. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore SH 03-N11-03:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “1,691.5” ndryshon në “1,674.74”.
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
62. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore SH 09-N11-08:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “258.3” ndryshon në “249.77”.
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
63. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore SH 09-N11-18:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “1,339.5” ndryshon në “1,194.35”.
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
64. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore SH 10-N11-01:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “853.0” ndryshon në “852.36”.
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
65. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore SH 10-N11-02:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “1,728.7” ndryshon në “1,635.08”.
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
66. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore SH 10-N11-03:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “743.9” ndryshon në “701.26”.
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
67. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore SH 10-N11-13:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “1,340.1” ndryshon në “1,337.91”.
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
68. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore SH 10-N11-23:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “302.5” ndryshon në “295.19”.
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.
69. Në “Tabelën e Treguesve të Zhvillimit” në njësinë strukturore U22-03:
- a) *Sipërfaqe (ha)*, nga “2.4” ndryshon në “1.77”.
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

Hartat Ilustruese e Njësive Strukturore me Ndryshime

Në hartat më poshtë ilustrohen njësitë strukturore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Malësi e Madhe, të cilat pësojnë ndryshime sipas Kreut II të këtij dokumenti.




Shtojca II

Koordinatat e Njësive Strukturore që pësojnë ndryshime të kufijve

Në hartat ilustruese të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Malësi e Madhe, koordinatat e kufijve të njësive strukturore që pësojnë ndryshime sipas Kreut II të këtij dokumenti, jepen në tabelat pjesë e shtojcës II.

Shtojca III

Paraqitja grafike e mbivendosjes së fashave mbrojtëse/të rezervimit të rrugëve kombëtare me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Malësi e Madhe dhe lista e Njësive Strukturore përkatëse



a) Njesitë strukturore që preken nga fasha mbrojtëse e rrugës “Koplik-Qafë Thore”:

b) Njesitë strukturore që preken nga fasha mbrojtëse e rrugës “Hani i Hotit-Tamarë-Vermosh”: